



Konkursi “Festat Lokale”

Konkursi “Festat Lokale” është një konkurs që nxit idetë e reja dhe inovative në fushën e turizmit, dhe ofron mundësi mbështetjeje për t’i sjellë në jetë. Nëse keni një ide të tillë, mund ta sillni atë nëpërmjet këtij konkursi.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me projektin RisiAlbania financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, organizon konkursin e parë kombëtar të quajtur “Festat Lokale” për zonat bregdetare, juglindore dhe zonat e identifikuara në strategjinë e “100 Fshatrave” në mënyrë që të nxisë zhvillimin e festivaleve tradicionale, të fokusuara rreth aktiviteteve kulinare, gastronomike dhe tradicionale; dhe/ose rreth aktiviteteve kulturore, fetare dhe historike. Këto aktivitete do të ndihmojnë për të krijuar mundësi të reja ekonomike duke i shtuar vlerë atyre ekzistuese, nëpërmjet bashkëpunimit me sipërmarrjen lokale duke siguruar një përvojë të pasur dhe autentike për turistët dhe vizitorët vendas dhe të huaj në këto rajone.

Ftohen të gjitha bashkitë e interesuara të dorëzojnë një Projekt Ide për të zhvilluar dhe zbatuar festivale autentike të kulinarisë apo traditës kulturore me fokus kryesor zonat bregdetare, juglindore dhe zonat e identifikuara në programin e “100 Fshatrave”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do mbështesë zërat e infrastruktuës në buxhet; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit merr përsipër të mbështesë në promovim, marketim dhe brandim të festave të përzgjedhura; Projekti RisiAlbania do të mbështesë bizneset lokale me konsulencë në prezantimin e produkteve tipike të këtyre festivaleve.

1. Qëllimi i konkursit për festivalin tradicional është:

- Të tërheqë më shumë turistë në rajonet e lartpërmendura;
- Forcimi i marrdhënieve ndërmjet Bashkive dhe sipërmarrjeve lokale. (si psh: operatorë turistikë; agropërpunues; prodhues; fermerë; përfaqësues të kulturës tradicionale, etj.);
- Të zgjasë sezonin turistik në këto rajone;
- Promovimi i produkteve tipike lokale;
- Të rrisë të ardhurat nga turizmi në këto rajone;
- Të rrisë mundësitë e punësimit sidomos për të rinjtë dhe grupet e marginalizuara në këto rajone.

2. Kriteret e vlerësimit

Juria e konkursit do t’i japë prioritet propozimeve të cilat marrin në konsideratë:

- Inovacionin, me fokus promovimin e produkteve dhe aktiviteteve tipike tradicionale të zonës të cilat promovojnë zhvillimin e ekonomive lokale;
- Bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm në sektorin e turizmit, ideve që përfshijnë përfitime për bizneset e ndryshme dhe palët e interesuara në këtë sektor;
- Gjenerimin e vendeve të reja të punës në sektorin e turizmit sidomos për të rinjtë dhe grupet e marginalizuara;



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



RisiAlbania

Partner for Growth



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

- Qëndrueshmërinë e festivalit- prezantimin e treguesve që do të sigurojnë vazhdimësinë e festivalit edhe në vitet në vijim. Ide të cilat përfshijnë fuqizimin ekonomik të grave përmes turizmit and agroturizmit në zonat rurale, etj.
- Ide që përfshijnë operatorë turistikë/ agjenci udhëtimi si pjesë e marketimit dhe shitjes së festivalit.

Kriteret e përgjithshme të vlerësimit do të aplikohen si më poshtë:

Pikët e vlerësimit të Projekt Ideve	Pikët
Inovacioni	15 pikë
Bashkëpunimi ndërmjet bashkive, operatorëve turistikë dhe bizneseve	20 pikë
Qëndrueshmëria e festave (identifikimi i sponsorave të ndryshëm për festën e parë dhe plani për financimin e saj në vitet në vijim)	25 pikë
Ndikimin në hapjen e vendeve të punës	20 pikë
Plani financiar, si edhe përqindja/sasia e kontributit të kërkuar	20 pikë
Totali i Pikëve	100 pikë

3. Kush mund të aplikojë dhe si?

Pjesëmarrësit në konkursin “Festat Lokale” duhet të jenë Bashki ose partneritet i bashkive me organizata. Inkurajohen aplikime në të cilat përfshihen bashkëpunime edhe me operatore turistike, biznese turizmi etj., për të siguruar bashkëpunimin në zinxhirin e vlerës së turizmit, si edhe promovimin e festivaleve.

Propozimet duhet të përfshijnë informacionin e kërkuar në formatin e projekt idesë. Të gjitha dokumentet dhe formatet mund të shkarkohen në www.bujqesia.gov.al ose në www.turizmi.gov.al

Aplikantët e interesuar për pjesëmarrje në konkursin “Festat Lokale” janë të ftuar në një sesion informimi në panairin e Turizmit Mesdhetar në Tiranë me kryetarët e Bashkive dhe Donatorë potencialë, zhvilluar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ku në panel do të jenë të pranishëm dy ministritë organizatore së bashku me RisiAlbani. **Data: 6-7/04/2018 Vendi: ExpoCity**

Në këtë sesion informimi, aplikantët e interesuar do të marrin udhëzimet e nevojshme mbi kushtet dhe formatin e aplikimit si edhe do të marrin përgjigje për pyetjet e tyre.

Të gjitha propozimet e plotësuara sipas formateve duhet të ngarkohen tek formulari tip me titull subjekti: Konkursi "Festa Lokale".

Afati i fundit për dorëzimin e Projekt Idesë është data **20 Prill 2018**. Të gjitha projektet konkurruese do të vlerësohen nga një juri e përbërë nga një panel ekspertësh. Projekt Idetë e përzgjedhura nga juria do të njoftohen brenda datës 23 Prill 2018, dhe do të ftohen për të prezantuar projektin në një aktivitet publik në **dt. 27 Prill 2018**.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Partner for Growth